



KËSHILLI DREJTUES

VENDIM QARKULLUES

Nr. 25, datë 27.08.2020

**Për miratimin e raportit mbi realizimin e buxhetit
të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave
për tremujorin e dytë të mbyllur në 30 Qershor 2020**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 52 pika 1, shkronja “l”, nenit 53, pika 5, shkronja “e”, nenit 62, pika 1 të ligjit nr.53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 6, pika 2, shkronja “d”, të nenit 7, pika 6, dhe nenit 8, pika 2, shkronja “m” të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr.24, datë 31.10.2018, të nenit 10, pika 6 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të miratojë raportin mbi realizimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për tremujorin parë të mbyllur në 30 Qershor 2020, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Sektori i Financës dhe Investimeve.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar